



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 117 prot.

Kamëz, më 27.07.2022

V E N D I M

Nr. 100 Datë 27.07.2022

MBI

“SHFUQIZIMIN E VKB NR.14 DATË 03.02.2022 PËR SUBJEKTIN NË LISTËN APLIKUESE I CILI KA PËRFITUAR NGA PROGRAMI I RINDËRTIMIT PËR OBJEKTET KOLEKTIVE, (PALLATET E VALIASIT) TË DËMTUARA NGA FATKEQËSIA NATYRORE E TËRMETIT TË DATËS 26 NËNTOR 2019”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 27.07.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.88 Datë 27.07.2022 në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Aktin Normativ nr. 09 datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” dhe aktet nënligjore për zbatim të tij; Vendimin nr. 750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar; Vendimin Nr. 904, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”; Vendimin Nr.5, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit dhe projektet model”; Vendimin Nr.8, datë 06.01.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja për banim nga subjektet që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje”; Vendimin Nr. 887, datë 24.12.2019 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurës së përsheptuar për hartimin dhe miratimin e planit të detyruar vendor, si dhe procedurës së miratimit të zhvillimit/ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”; Vendimin nr. 22, datë 13.02.2020, të Këshillit Bashkiak Kamëz; **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e shfuqizimit të VKB nr.14 datë 03.02.2022 për subjektin në listën aplikuese i cili ka përfituar nga programi i rindërtimit për objektet kolektive, (Pallatet e Valiasit) të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore e tërmetit të datës 26 nëntor 2019.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

2. Shfuqizimin e subjektit aplikues **Aleksandër Zefi** nga VKB nr.14 Datë 03.02.2022 i cili ka përfituar njësi banimi me tipologji 3+1; Arsyetimi i shfuqizimit bëhet në zbatim të faktit se nuk ka pasur banesë në objektet kolektive (Pallatet Valias), bazuar në vërtetimin e UKK-së.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga fondet e rindërtimit të transferuara nga Këshilli i Ministrave në buxhetin e Bashkisë Kamëz;
4. Ngarkohen Kryetari i Bashkisë Kamëz; Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Strehimit; Drejtoria e Çështjeve Ligjore; Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit; Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit, dhe Drejtoria e Rindërtimit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi **pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI

Hysen KOLDASHI

